



Republika e Kosovës - Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica - Municipality of Gjakova



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. 352/01-27436/2018

Dt.26.09.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010), nenit 12 dhe 17 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 1, pika (p), Neni 17 pika ”b”, Neni 55, pika “m” të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe kërkesës nr.ref. 120/IKMN/2018, të datës 22.01.2018 nga Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2018 pas diskutimit në pikën e 7 të rendit të ditës të Ndryshme, lidhur me rekomandimin e MAPL-së dhe MMPH-së për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimeve për shpalljen nën mbrojtje si monumente të natyrës nxjerr këtë:

V E N D I M PËR

MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “BURIMI I UJIT” NË MOLLIQ TË GJAKOVËS SI MONUMENT I NATYRËS

Neni 1

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës “BURIMI I UJIT” në fshatin Molliq të Gjakovës, Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
2. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike hidrologjike, vlera të tjera natyrore dhe si i tille është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Gjakovës dhe përfshin sipërfaqe të mbrojtur prej 2 ari 50 m².

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur “Te vrella” afër shkollës së fshatit, në parcelën 009-0, zona kadastrale Molliq, nr. P-70705051-00009-0, me sipërfaqe 249 m², e regjistruar si pronë shoqërore.

Neni 3

1. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i kategorisë së III-të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
2. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
 - 2.1. Ndërhyrja në burim dhe rreth tij,
 - 2.2. Çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme të burimit,
 - 2.3. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
 - 2.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur dhe
 - 2.5. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.
3. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

3.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 4

1. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohej:
 - 1.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
 - 1.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
 - 1.3. Ndërrimi i kulturës,
 - 1.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të Natyrës.
2. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

Neni 5

1. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, është përgjegjëse Komuna e Gjakovës.
 - 1.2. Personi fizik apo juridik është përgjegjës që:
 - 1.2.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
 - 1.2.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
 - 1.2.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me legjislacionin në fuqi për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Neni 8

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

Z. Anton Shala